Kronikë

EMRI/ 'Pse me parakalove' sherr mes të rinjve në Shkodër! 28-vjeçari merr kallashin dhe i drejtohet shoferit, ngjarja e rëndë parandalohet nga policia

Një 28-vjeçar është shpallur në kërkim nga Policia e Shkodrës, pasi i është drejtuar me kallash shoferit të një makine, i cili bëri një parakalim të gabuar. Nën hetim janë vënë katër persona të tjerë pasi kanë tentuar të fshehin armën e 28-vjeçarit.

Kallashi i sekuestruar

Redaksia
17 Korrik, 13:30 | **Përditesimi: 17 Korrik, 13:33**

VAU I DEJËS-Një 28-vjeçar është shpallur në kërkim nga Policia e Shkodrës, pasi i është drejtuar me kallash shoferit të një makine, i cili bëri një parakalim të gabuar. Nën hetim janë vënë katër persona të tjerë pasi kanë tentuar të fshehin armën e 28-vjeçarit.

Shpallet në kërkim Mark Preka.

LEXO EDHE:
EMRAT/Elbasan, qëlluan me armë në ajër pas një konflikti me dy vëllezër! Në kërkim autorët, ndërsa një 40-vjeçar u vu në pranga

Njoftimi i policisë:

Pas një konflikti të çastit për parakalim të gabuar me automjet, midis shtetasve M. P., 28 vjeç dhe A. Gj., 23 vjeç, shtetasi M. P. është larguar dhe ka marrë armën e zjarrit tip automatik që mbante me vete.

Ndërhyrja e menjëhershme e shërbimeve të Komisariatit të Policisë Vau i Dejës ka parandaluar përshkallëzimin e konfliktit midis këtyre dy shtetasve. Gjatë ndjekjes nga Policia, shtetasi M. P. ka hedhur armën e zjarrit dhe është larguar.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, ka nisur procedimi në gjendje të lirë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", për shtetasit A. H., 21 vjeç, K. Sh., 19 vjeç, R. H., 30 vjeç dhe Xh. H., 25 vjeç, të gjithë banues në fshatin Barbullush, Vau i Dejës, pasi kanë tentuar të fshehin armën e zjarrit që mbante shtetasi M. P.

Vijon puna për kapjen e shtetasit M. P.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Lajmi në përditësim...

M.T/Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | vau i dejes | sherr | arme pa leje | ne kerkim | Mark Preka

Komento

Komente

emri: 17/07/2023 15:26
Kafshe te tilla me fytyra njeriu, ka kudo. Ne tirane plot e perplot. Vrases qe te vine nga mbrapa e te ndezim dritat e gjata gjithe inat, ne nje rruge cope cope, pa ndricim ku je duke ecur dhe ti mbi shpejtesine limit, kompletuar me vhama te zij e te flakin pa asnje shkak. Te dalin preparat e mbajne freno qellimisht para teje te te ndeshkojne ty e makinen tende se nuk u hape rrugen(se jane ne nxitim duke cuar e mare droges e radhes) , duke rezikuar te te marin jeten.... vertet lista este e gjate. Parakalimi eshte me e pakta qe keto kasha te marin inat, se jane ne inat mevehten gjithe kohes Keto jane nje ekskrement shoqeror qe fatkeqesisht shqiptareve u duhet te ndajne mugen cdo dite te perendise.

Përgjigju

Alb: 17/07/2023 14:13
Ku ka shku djepi i kultures.

Përgjigju

joker: 17/07/2023 14:56
ska lidhje ajo kudo ke kshu , jane rini e cthurur

Eri: 17/07/2023 14:20
Po cfar djepi i kultures mor. Kjo ka ndodh ne vau i dejes. Bashki krejt tjeter. Sdi pse e shkrujn Shkoder kot

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kurti bojkoton takimin informal BE-Ballkani në Tiranë, si e vlerësoni?

E drejtë | E gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

EMRAT/ Babë e bijë shkuan për të shkëputur martesën në shtëpinë e dhëndrit, plas sherri mes dy familjeve në Durrës! 3 në pranga, një në hetim
17 Korrik, 12:15

Goditi me grushte dhe thikë një person, pas një konflikti për motive të dobëta! Në pranga 16-vjeçari në Durrës
17 Korrik, 11:37

Policia u bllokoi varkat në lumin e Shalës, pronarët dhe turistët në protestë bllokojnë për gati 8 orë tunelin e Komanit, ndërhyn policia
15 Korrik, 10:23

Ish kryebashkiaku i Fushë-Arrëzit mbetet në burg, e vendos GJKKO! Me administratorin e Iballës akuzohen se hapën rrugë të re duke shkatërruar pyllin, dëmi 234 mln lekë!
14 Korrik, 10:45

FOTO/ Ja rruga e re që hapi ish-krebashkiaku i Fushë Arrëzit, shkatërroi pyllin, dëmi 234 mln lekë
14 Korrik, 10:01

Sezoni turistik, pushuesit në plazhin e Velipojës: E mbajnë pastër, janë shtuar hapësirat publike
14 Korrik, 08:18

Policia bllokoi varkat e lumit të Shalës, banorët e Temalit ankohen në bashkë! Shkreli: Varkat janë të pa kolauduara, por unë do ju mbështes
13 Korrik, 16:54

VIDEO/ Vrasja në Selanik, momenti kur 50-vjeçari shqiptar qëllohet për vdekje në një pikë karburanti! Kamerat fiksuan gjithë ngjarjen
13 Korrik, 15:09

VIDEO/ Ekzekutohet me tre plumba shqiptari në Selanik! U përlesh me autorët jashtë një karburanti! Autori në kërkim
13 Korrik, 13:52

Arrestohet me urdhër të SPAK ish-kryetari i bashkisë në Fushë-Arrëz, Fran Tuci dhe administratori i njësisë Iballë! Hapën rrugë të re duke shkatërruar pyllin, dëmi 234 mln lekë
13 Korrik, 08:38

Durrës/Kreu veprime të turpshme ndaj vajzës së bashkëjetueses së tij, në pranga 38-vjeçari i shpallur në kërkim
12 Korrik, 11:22

Ishin shpallur në kërkim për kultivim të bimëve narkotike, arrestohen dy të rinj në Krujë (EMRAT)
11 Korrik, 09:32

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje